

Mesazhet kryesore për repartet e urgjencës – mjekët dhe menaxherët

1. Ju jeni në një pozitë të rëndësishme për të përmirësuar përshkrimin e antibiotikëve si në spitale ashtu edhe në kujdesin parësor, pasi që reparti juaj ndodhet në pikëtakimin ndërmjet spitalit dhe komunitetit [77].

2. Terapia me antibiotikë që fillon në repartin tuaj ndikon fuqishëm në mënyrën se si do të vazhdojë në spital dhe në institucionet shëndetësore në komunitet [77].

Detyrat

3. Detyrat tuaja klinike që lidhen me përmirësimin e përdorimit të antibiotikëve përfshijnë [102] [konsensusi i ekspertëve]:

a) Zbatimin e udhëzimeve lokale të përdorimit të antibiotikëve të bazuar në prova për infeksionet e zakonshme;

b) Vendimin për dhënien e dozës së parë të antibiotikut për pacientët e pranuar në spital;

c) Marrjen e kulturave përkatëse diagnostike, para fillimit të terapisë me antibiotikë, të cilat do të mundësojnë që terapia me antibiotikë të adaptohet ose të ndërpritet gjatë qëndrimit në spital;

d) Komunikimin e gjithë sfondit përkatës të informatave për pacientin dhe vendimeve të trajtimit, me mjekun kurues në spital ose në kujdesin ambulator.

e) Informimin e pacientëve (dhe familjeve të tyre) në lidhje me indikacionin për të përshkruar antibiotikë, efektet anësore të mundshme dhe përdorimin korrekt të tyre.

4. Detyrat e repartit përfshijnë [77] [konsensusi i ekspertëve]:

a) Vënien në dispozicion të udhëzuesve për trajtimin me antibiotikë në spital, të cilat bazohen në dëshmi dhe të shtigjeve klinike (clinical pathways) për diagnostikimin, trajtimin dhe menaxhimin e infeksioneve më të zakonshme që hasen në repartin tuaj (p.sh. infeksionet e traktit respirator, infeksionet e lëkurës dhe indeve të buta, infeksionet e traktit urinar dhe sepsa). Kjo duhet të përfshijë indikacionin, përzgjedhjen e ilaçit, dozën, rrugën e administrimit dhe kohëzgjatjen e trajtimit.

b) Sigurimin që udhëzuesit të marrin në konsideratë profilin lokal të mikrobiologjisë dhe rezistencës ndaj antibiotikëve dhe të pasqyrojnë formularin ekzistues spitalor.

c) Fuqizimin e përcjelljes dhe interpretimit në kohë reale të të dhënave të kulturës mikrobiologjike, duke u koordinuar me laboratorin e mikrobiologjisë për të njoftuar mjekët me kohë për rezultatet laboratorike.

d) Edukimin e stafit mbi sëmundjet infektive dhe përdorimin e përgjegjshëm të antibiotikëve.

Çka mund të bëni?

5. Zbatoni protokollet e trajtimit me antibiotikë, sipas udhëzimeve të bazuara në prova (p.sh. për sepsën [74], infeksionet e traktit urinar [103], infeksionet e lëkurës dhe indeve të buta [104]) dhe zbatoni masat e parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve në institucionin tuaj [31] [konsensusi i ekspertëve].

6. Merrni anamnezën e plotë të pacientit kur përshkruani një antibiotik, duke përfshirë përdorimin e fundit të antibiotikëve, alergjitë ndaj ilaçeve, përdorimin e terapisë immunosupresive dhe faktorët e rrezikut për rezistencën ndaj antibiotikëve (p.sh. a ka pasur pacienti ndonjë spitalizim, procedurë ose udhëtim jashtë Evropës gjatë kohës së fundit) [31].

7. Keni vëmendjen në profilin lokal të rezistencës ndaj antibiotikëve në komunitet, spital dhe repart [31] [konsensusi i ekspertëve].

8. Filloni trajtimin me antibiotikë vetëm nëse ka dëshmi të një infeksioni bakterial dhe mos e trajtoni kolonizimin me baktere [31,72].

9. Shmangni profilaksinë e panevojshme me antibiotikë [31,73].

10. Te pacientët me infeksion të rëndë, filloni trajtimin efektiv me antibiotikë sa më shpejt të jetë e mundur [31,74].

11. Të siguroheni që kulturat përkatëse mikrobiologjike të merren para fillimit të trajtimit me antibiotikë [31,42,70,71].

12. Në fletëregjistrin e pacientit dokumentoni arsyet e trajtimit me antibiotikë, përzgjedhjen e ilaçit, dozën, mënyrën e administrimit dhe kohëzgjatjen e trajtimit [31,42,70,71].

13. Nëse keni dyshime para se të përshkruani një antibiotik, duhet të [25,26,53,70] [konsensusi i ekspertëve]:

- Kontrolloni të dhënat epidemiologjike lokale, rajonale dhe kombëtare;
- Kërkoni udhëzime dhe këshilla nga një koleg me më shumë përvojë ose një anëtar i ekipit të administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve.

14. Merrni pjesë rregullisht në kurse trajnimi dhe në takime që mbështesin në nivel spitali: a) përdorimin e përgjegjshëm të antibiotikëve, b) udhëzuesit lokalë të antibiotikëve, që bazohen në prova dhe c) masat e parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve [52,53].